
AKT THEMELIMI

"Kastrati Holding" SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë **"Kastrati Holding" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortakë të shoqërisë janë:

- **"KASTRATI" SHPK** me nr. NUIS M21612025K me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri, zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë;


3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- **Funksionimi si një shoqëri HOLDING, me pjesëmarrje direkte ose indirekte në kapitalin tregtar të shoqërive të tjera tregtare, vendase ose të huaja. Në funksion dhe zbatim të objektit të veprimtarisë tregtare, shoqëria mund të kryejë çdo veprim, operacion apo transaksion të ligjshëm tregtar e financiar, duke përfshirë por pa u kufizuar në të drejtën e saj për të investuar në instrumente financiare, tituj pjesëmarrje në kapitale, tituj borxhi, aksione e kuota dhe/ose fonde investimesh. Aktivitetet në fushën e pasurive të paluajtshme të çdo lloji, duke përfshirë toka, troje, ndërtesa banimi dhe shërbimi, blerje, shitje, ndërmjetësim, dhënie dhe marrje me qira të këtyre pasurive të paluajtshme brenda dhe jashtë vendit. Investime në pasuri të paluajtshme duke përfshirë projektimin, financimin, ndërtimin, menaxhimin dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur me sa më sipër, pa asnjë përjashtim. Veprimtari në fushën e turizmit dhe zhvillimit infrastrukturor.**

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.



4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 100 000 (njqind mije leke).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuote me vlerë nominale ALL 100 000 (njqind mije leke) dhe zotërohet nga Ortakët e shoqërisë sipas pjesëmarrjeve në kapitalin e shoqërisë sa më sipër.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Enea Alinj, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 14.11.1995, banues në Tiranë, e identifikuar nga pasaporta me nr. BA3076667 dhe nr. personal J51114028G.**

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKËT E
SHOQËRISË "Kastrati Holding" SHPK

"KASTRATI" SHPK

Përfaqësuar nga Z/Zj.

Eda Spahiu

Eda Spahiu



Tiranë më **07.01.2025**